pushimi i gjykimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit në seancën e pajtimit parashikohet në nenin 135/1 të K.Familjes, i cili përcakton se: **"Në rast se në seancën e pajtimit nuk paraqitet paditësi, ndonëse ka pasur dijeni rregullisht, gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit të çështjes".** Në lidhje me shkaqet e mosparaqitjes neni 175 i K.Pr.Civile parashikon se: *"Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër".* Rezultoi se përfaqsuesja e paditësit ka marrë njoftimin më datë 12.04.2024 dhe po atë ditë i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shtyrjen e seancës, pasi sipas saj, në të njëjtën ditë do të marrë pjesë në një gjykim tjetër në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar kurse vetë paditësi jeton në Greqi dhe nuk mundi të sigurojë leje në vendin e punës për të ardhur në Shqipëri. Pra, ajo konfirmon faktin e njoftimit të paditësit, kurse në lidhje me shkakun e parashtruar për shtyrjen e seancës pajtimore, gjykata vlerëson se ai është i pabazuar, pasi: Së pari: Sipas nenit 134/1 të K.Familjes, në seancë për pajtim palët paraqiten personalisht dhe jo përfaqsuesit e tyre, prandaj pjesëmarrja e avokates në një gjykim tjetër nuk mund të shërbejë si shkak për shtyrjen e seancës pajtimore. Së dyti: Edhe pretendimi se paditësi punon në Greqi dhe nuk mund të merrte leje për tu paraqitur në gjykatë nuk mund të shërbejë si shkak për shtyrjen e seancës pajtimore, pasi gjykata nuk ka mundësinë dhe as për detyrë të verifikojë se kur mund ti jepet lejë paditësit dhe të planifikojë seancën. Po kështu, kërkesa e paditëses për shtyrjen e seancës është bërë menjëherë sapo ka marrë akt njoftimin e gjykatës në datën 12.04.2024 ndërkohë që seanca ishte planifikuar pas 17 ditëve nga marrja dijeni. Kjo tregon se paditësi nuk ka patur mundësi të kontaktonte me punëdhësin për marrjen leje, prandaj gjykata vlerëson se kërkesa është bërë vetëm për faktin e pjesëmarrjes së avokates në një gjykim tjetër, e cila nuk mund të shërbejë si shkak për shtyrjen e seancës pajtimore.

Përsa i takon shpenzimeve gjyqësore, paditësi ka parapaguar tarifën mbi aktet në vlerën 3.000 lekë, të cilat në kushtet kur gjykata vendos pushimin e gjykimit duhet të lihen në ngarkim të tij.

M.q.s. midis palëve nuk ka detyrime reciproke, ky vendim nuk përbën titull ekzekutiv e për rrjedhim nuk ka vend për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 135/1 të K.Familjes dhe nenin 299/ç të K.Pr.Civile,

VENDOSI:

-Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr. regj.21001-00454-41-2024 (1436), datë regjistrimi 19.03.2024, me paditës Vladimir Hysa, e paditur Manuela Hysa, me objekt zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve më datë 27.08.1999 dhe të pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

-Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të paditësit.

-Kundër këtij vendimi, paditësi ka të drejten e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 29.04.2024.

SEKRETARE
Eriselda ELMAZAJ

GJYQTAR
Seladin PYSQYLI

RR 642 151 039 AA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Nr.regj.21001-00454-41-2024 (1436)
Datë regj.19.03.2024

Nr.vendimi 41-2024-1494(436)
Datë vendimi 29.04.2024

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:

Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI,** asistuar nga sekretare Eriselda Elmazaj, në gjykatë, sot më datë 29.04.2024, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

PADITËS: Vladimir Hysa, i biri i Pasho dhe Lumturije, i datëlindjes 13.04.1975, lindur në fshatin Bersnik të Rrethit Gramsh dhe banues në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq, i papranishëm.

E PADITUR: **Manuela Hysa (mbiemri paramartesor Veli),** e bija e Muhamer dhe Feride, lindur në Korçë dhe banuese në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq, e papranishme.

OBJEKTI: Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve më datë 27.08.1999, si dhe zgjidhjen e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

Baza ligjore: Neni 132 e vijues i K.Familjes.

Gjykata, pasi verifikoi prezencën e palëve dhe rezultoi të mos jetë paraqitur asnjëra prej tyre,

VËREN SE:

Me padinë drejtuar gjykatës, paditësi ka kërkuar zgjidhjen e marteses ligjore të lidhur më datë 27.08.1999, midis tij dhe të paditurës Manuela Hysa, si dhe zgjidhjen e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

Pasi çështja i'u nënshtrua shortit elektronik, bazuar në nenin 134 të K.Familjes, gjykata caktoi seancën për pajtim dhe urdhëroi njoftimin e palëve ditën e sotme, datë 29.04.2024, ora 09:00. Në këtë seancë nuk u paraqit asnjëra nga palët, ku për paditësin njoftimi u bë nëpërmjet avokates Anxhela Lami antare e Dhomës Vendore të Avokatisë Tiranë, e zgjedhur me prokurë të posaçme, kurse njoftimi i të paditurës u bë në adresën e dhënë në padi, në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq. Përfasuesja e paditësit ka marrë njoftimin më datë 12.04.2024 dhe po atë ditë i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shtyrjen e seancës, pasi sipas saj, në të njëjtën ditë do të marrë pjesë në një gjykim tjetër në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe krimit të Organizuar kurse vetë paditësi jeton në Greqi dhe nuk mund të sigurojë leje në vendin e punës për të ardhur në Shqipëri. Në lidhje me të paditurën fletëthirrja u kthye me shënimin "larguar".

Gjykata, pasi verifikoi prezencën e palëve dhe u njoh me akt njoftimet, referuar nenit 299/ç të K.Pr.Civile, çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit, pasi kjo dispozitë parashikon: **"Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj".** Në rastin konkret jemi para një padie me objekt zgjidhje martese dhe

BASHKIA MA...
Zyra e Protokollit
Nr. 3858 Prot
Date 24.06.24 Nenshkrimi
I.Hadem

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 20.06.2024

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : **Njësia Adm.Vreshtas, Bashkia Maliq**

Për shtetasin/en: Manuela Hysa
Me adresë: Fshati Bregas,Njësia Adm.Vreshatas,Bashkia Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 436 dt. 29.04.2024 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi dëftesa e komunikimit është kthyer e pakonfirmuar dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Për Njësinë Administrative/Bashkinë

(emër, mbiemër, firmë)

Nj.A. Vreshtas
ST 1919
dt 24.06.2024

Nr. 152 Prot